

VENDIM
Nr. 668, datë 29.7.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “MUKA”, SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “MAGAZINA NR.
145”, NË NDËRMARRJEN E PRODHIMIT TË ÇELIQEVE, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse dhe shoqërisë “Muka”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Magazina nr. 145”, në Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan, me sipërfaqe të përgjithshme 5393.3 (pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre pikë tre) m², nga të cilat: sipërfaqe nën objekt, 2760.25 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e pesë) m² dhe sipërfaqe funksionale, 2633.05 (dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre pikë zero pesë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama